



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr. 8, datë 30.6.2007

PËR

MIRATIMIN E UDHËZIMIT TË PËRBASHKËT PËR
EVIDENTIMIN DHE LEGALIZIMIN E PUS-SHPIMEVE

Në mbështetje të shkronjës "a", të nenit 6, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të ministrit të Brendshëm, për evidentimin dhe legalizimin e pus-shpimeve, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ministri i Brendshëm dhe kryetarët e këshillave të baseneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI


SALI BERISHA

Lufter XHUVELI


Zëvendëskryetar

dhe
ministër i Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit të Ujërave


K. K. U



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**Ministria e Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit te Ujerave**

Nr 307 prot.date 5.07.2007

**Ministria e Ekonomise, Tregtise
dhe Energjetikes**

Nr 5109 prot.date 6.07.2007

Ministria e Brendeshme

Nr 6199 prot.date 10.7.07

UDHEZIM I PERBASHKET

Mbeshtetur ne konkluzionet e mbledhjes te Keshillit Kombetar te Ujit te dates 7.6.2007,

Bazuar ne shkronjen "a", pika 1, neni 6 dhe nenin 24 te ligjit 8093 date 21.3.1996 "Per rezervat ujore",

Ne zbatim te vendimeve nr 3 date 7.6.2007 dhe nr 4 date 19.7.2002 te KKU,


UDHEZOJME:

1. Shpimi i puseve per uje te behet vetem ne perputhje me kerkesat e nenit 24 te ligjit nr 8093 date 21.3.1996 "Per rezervat ujore" dhe vendimet nr 3 date 7.6.2007 dhe nr 4 date 19.7.2002 te KKU.
2. Keshillat e Baseneve Ujembledhes, brenda muajit Tetor 2007, te evidentojne gjendjen e pus çpimeve ne basenet perkatese. Per kete:
 - a) Te ngrihen grupe pune me perberje nga Agjensite e Ujit te Baseneve, Organet e Qeverisjes Vendore dhe Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, te cilet te evidentojne gjithë pus çpimet.
 - b) Sherbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Drejtoria e Politikave te Mbrojtjes se Natyres te hartojne brenda 10 Korrikut 2007 formularin tip, bazuar ne vendimin nr 3 date 7.6.2007 te KKU, me te dhenat me te domosdoshme e te mundeshme per evidentimin e pus çpimeve ne kete faze.

- c) Per pus çpimet e hapura deri ne date 1.7.2007 te kerkohet paraqitja e dokumentacionit perkates prane Agjensive te Ujit të Baseneve dhe paisja e tyre nga Keshillat e Baseneve me leje perdorimi, kundrejt tarifave te sherbimit.
- d) Nje kopje te raportit te detajuar hidrogjeologjik ne lidhje me çpimin dhe mostrat e shtresave te shpuara, Agjensite e Ujit te Baseneve ja dorezojne zyrtarisht Sherbimit Gjeologjik Shqiptar.
3. Ndaj subjekteve qe nuk paraqesin brenda muajit Gusht 2007 dokumentacionin per te legalizuar pus çpimet e bera deri ne 1.7.2007 dhe ndaj pronareve te puseve dhe kompanive ose sondave qe vazhdojne te kryejne shpime pa leje, te zbatohen saksionet e parashikuara ne nenin 1 te ligjit nr 8605 date 20.4.2000 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.8093 date 21.3.1996" dhe nenin 1 te ligjit nr 8736 date 1.2.2001 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8093 date 21.3.1996 "Per rezervat ujore" ,ndryshuar me ligjin nr 8605 date 20.4.2000".
4. Keshillat e Baseneve Ujembledhes ta analizojne ne cdo muaj ecurine e evidentimit dhe legalizimit te çpimeve te puseve pa leje dhe te informoje me shkrim ne MMPAU.
5. MMPAU (sektori i ujerave) te ndjeke me pergjegjesi e te koordinoje veprimtarine e grupeve te punes dhe Keshillave te Baseneve Ujembledhes, per evidentimin dhe legalizimin e puseve pa leje dhe ne perfundim te procesit te legalizimit te raportoje ne KKU.
6. MMPAU dhe METE te organizojne fushate medjatike per vetdeklarimin e puseve dhe rritjen e ndergjegjesimit publik per perdorimin e ujit me ekonomi.


Lufter XHUVELI

**Minister i Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit te Ujerave**



Genc RULLI

**Minister i Ekonomise, Tregtise dhe
Energjetikes**



Bujar NISHANI

Minister i Brendshem



FORMULARI I IDENTIFIKIMIT DHE ANALIZIMIT TE PUS-SHPIMIT

IDENTIFIKIMI I PUS-SHPIMIT

Emer mbiemer/Subjekt privat
Telefon
Fshati
Komuna/Bashkia
Qarku
Koha e hapjes se pus-shpimit
Data e evidenimit te pus-shpimit

PERIZIMI I PUS-SHPIMIT

Per biznes (lloji i aktivitetit)

Per konsum familjar

ANALIZIMI I PUS-SHPIMIT

Nr i identifikimit te pus-shpimit
Kordinatat e pus-shpimit X Y Z
Thellesia e pus-shpimit (ml)
Diametri i pus-shpimit (mm)
Konstruksioni i pus-shpimit
Prurja (l/s) i pus-shpimit
Sasia e ujit qe do te perdore (l/s)
Personi/Subjekti qe ka kryer shpimin
Ne se ka analiza te ujit:

- Kimike
- Bakterologjike

Po Jo
Po Jo

Sherbimi Gjeologjik Shqiptar

AUB _____

(_____)

(_____)

Perfaqsesi i Komunes/Bashkise

Pronari i pus-shpimit

(_____)

(_____)

Z. Hoxha
Sez. B. Myze
Shkollor
23.11.09

2429

30.11.2009



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT TIRANE

Sektori Kompetencave Vendore

Sheshi "Mustafa Qemal Atatürk", Tel. (04)240867, Fax. (04)240866, e-mail: prefekturatirane@yahoo.com

Nr 3776 Prot.

Tiranë, me 18.11.2009

LENDA: **Kërkohet informacion mbi situatën e pus-çpimeve**

DREJTUAR: **AGJENSISE SE BASENIT UJOR ISHEM - ERZEN**

SHERBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR

PER DIJENI: **MINISTRISE SE MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**

Në zbatim të vendimit Nr. 8 datë 30.06.2007 dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës e të Ministrisë së Brendshme, kërkohet të përcillni në institucionin tonë brenda datës 30.11.2009, informacion të detajuar për situatën e pus-çpimeve në Qarkun e Tiranës.

Në informacion të pasqyrohet puna periodike e realizuar nga institucioni juaj në bashkëpunim me grupin e ngritur për inventarizimin dhe legalizimin e pus-çpimeve, gjëndja e tyre dhe masat e marra nga kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve që veprojnë në kundërshtim me ligjet për shfrytëzimin e rezervave ujore.

Ju faleminderit.

Referente!
shkruar me SCB - m (w status 8 0244-4-B)
e cdo deri te prapke zjed vendoset
me pasqy u EB9 dhe deri te
referencat s MINISTRI



KELTIS KRUIJA

PREFEKT

[Handwritten signature]